- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
 - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>6</i> | |
|-----------------|---|--------------|---------------|--|--|
| Shërbimi | Përshkrimi i shërbimi | Sasia | Njësia | Çmimi total për shërbim(3 x 4X) | |
| 1. | Sistemi fiskalizimit dhe e-faturimit për periudhën 1 vjeçare | 1 | vit | | |
| 2. | Moduli i lidhjes automatike me modelin API për raportimin e faturave të shitjes; nga sistemi i brendshëm i faturimit. | 1 | modul | | |
| 3. | Sistemi i leshimi i faturave manual në zyrat rajonet e UKT; | 1 | modul | | |
| 4. | Sistemi i miratimit të | 1 | set | | |

| | | | | | |
|---|--|---|-----|--|-------|
| | faturave ne blerjen, ne nje ëorkfloë me minimalisht 3 aprovime | | | | |
| 5. | Sistemi i raportimit BI, mbi raportimin dhe analizen mbi faturat | 1 | vit | | |
| 6. | Sherbimi ëeb per lidhjen online te operatoret e pagesave. | 1 | vit | | |
| 7. | Mirembajtje ne vend per periudhe 1 vjecare | 1 | vit | | |
| | Çmimi total (Shërbimet) | | | | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH | | | | | |
| TVSH (%) | | | | | |
| Çmimi total me TVSH: | | | | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | | | | |
| Nënshkrimi | | | | | |
| Vula | | | | | |
| Datë _____ | | | | | |

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Fiskalizimi i faturave dhe administrimi i faturave elektronike

Në bazë të ndryshimeve ligjore që kanë hyrë në fuqi në Janar të vitit 2021 nevojitet një sistem që të mundësojë fiskalizimin e faturave elektronike.

Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e regjistrimit manual të faturave si dhe të mund të integrohen me sistemin e faturimit me UKT si dhe të ketë mundësinë në vazhdim mund të integrohet me sisteme të tjera të ngjashme që UKT mund të zbatohet në vazhdim, me qëllim shpejtimin procesit të fiskalizimit, rritjen e saktësisë së veprimeve dhe uljen e rrezikut në regjistrimin e dyfishtë të faturave.

Per kete sistemi kerkohet te jete i teknologjise se hapur dhe vec integrimi ve fillestare te sistemeve:

- te faturimit (al-Billing);
- te sherbimeve ne arka; te dhe atij te
- raportimit te faturave per subjekte e pagesave (bankave apo e ngjashem per arketimin e faturave),

sistemi duhet te ofroje mundesine e integrimi ne vazhdim me sisteme te tjera te ngjashem te operimit te brendshem si ai financiar. Sherbimet e Fiskalizimit qe do te integrohen jane te njejta me kerkesat ne kete prokurim, pra fiskalizimi me dhe pa para në dorë Pa para në dorë e-invoice; faturë shoqëruese; si dhe sherbimi i pagesave.

Nderkohe qe lidhja me sistemin e faturimit; arkivimi i dokumentave; email; web service me bankat e nivelit te dyte, apo te tjera .. te percaktuara brendave ToR jane qellimi i projektit.

Per kete, sistemi duhet te jete nje sistem i hapur per te lejuar integrimin ne cdo kohe te sistemve apo moduleve te reja te brendshme te UKT. OE duhet te demonstroje menyren e realizimit te lidhjeve te reja *pa programim*.

1. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1. Qëllimi

Qëllimi i krijimit të këtij Sistemi Informatik është

- Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. Perfshire 10 perdorues per hedhjen e faturave te shitjes si dhe per pranimin e atyre te blerjes.
- Moduli i lidhjes automatike me modelin API per raportimin e faturave te shitjes nga sistemi i brendshem i faturimit efatura.
- Instalim & trajnim stafi
- Mirembajtje ne vend per periudhe 1 vjecare

2. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Transparencë e plotë e procesit të fiskalizimit te faturave dhe administrimit te faturave elektronike si edhe integrimin me sisteme të tjera për të kryer tërësinë e funksionaliteteve të kërkuara:

- Të implementojë proceset për menaxhimin e çështjeve:
 - Procese për menaxhimin e faturave elektronike.
 - Konfigurimi i sistemit te fiskalizimit per arkivimin/dergimin e faturave prane sistemit te faturimit. Kjo konsiston ne shkarkimin e faturave te fiskalizuara prane server lokal ku ruhet sistemi i faturimit al-billing.
 - Ndërtimi i proceseve të rrjedhës së fiskalizimit për tu lidhur me sistemin e faturimit te UKT.
 - Mundesimin e leshimit te faturave te fiskalizuara ne cdo kohe;
 - Mundesine e leshimit te fleteve te shoqerimit nga cdo njesi e UKT;
- Të identifikojë rolet e përdoruesve në secilin proces.
- Kontraktori duhet të integrojë njoftimet me email sipas konfigurimeve të procesit për të rritur ndërveprueshmërinë e përdoruesve me sistemin.
- Të realizohet aksesimi i sigurtë i sistemit prej kudo (brenda dhe jashtë rrjetit të UKT).
- Të konfiguroje hapa/ndërfaqet e reja të sistemit aktual qe lidhen me workflow (rrjeshen e aprovimin) te aprivimit te faturave te blerjeve. Cdo shtese ne process duhet të jenë intuitive dhe të thjeshta në përdorim..
- Aplikimi duhet të jetë në gjuhën Shqipe dhe Angleze.
- Kontraktori duhet të sigurojë manuale në gjuhën shqipe të përditësuar sipas implementimit që do të bëhet në projektin konkret.
- Kontraktori duhet të bëjë trajnimin e stafit të përfshirë sipas një kalendari të dakordësuar midis palëve. Stafi që do të trajnohet do të ndahet në grupe sipas roleve që do të kenë në sistem.

2. QËLLIMI I PUNËS

1. Të Përgjithshme

Sistemi i ofruar, ne baze te ndryshimeve ligjore qe kane hyre ne fuqi ne Janar te vitit 2021, duhet te mundesoje fiskalizimin e faturave si dhe menaxhimin e fatures elektronike. Sistemi duhet te ofroje mundesine e regjistrimit manual te faturave si dhe te mund te integrohet me sistemin e faturimit me UKT si dhe te kete mundesine ne vazhdim te integrohet me sisteme te tjere te ngjashem qe UKT mundet te zbatoje ne vazhdim, me qellim shpejtimin procesit te fiskalizimit, rritjen e saktetise se veprimeve dhe uljen e rezikut ne regjistrimit te dyfishte te faturave.

2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Hapësira gjeografike janë zyrat administrative te UKT si dhe ne njesite e saj ne Tirane.

3. Detyrat specifike

Detyrat kryesore specike që duhet të realizojë kontraktori janë:

1. Analiza e projektit për të përcaktuar procedurat e punës dhe funksionalitetet e nevojshme.
2. Hartimi i një dokumenti përshkrues të sistemit.
3. Implementimi i sistemit.
4. Modifikime dhe personalizime te raporteve ne sistemin e raportimit.
5. Dorëzimi i manualit të përdorimit.
6. Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit)

3. LOGJISTIKA DHE KOHA

1. Vendndodhja

Baza operative e projektit do të jetë në Tirane. zhvillimet qe lidhen me integrimin e sistemit do të realizohen me sistemin aplikacionin e faturimit (al-billing) si dhe server te email (Mail Server) qe operohen në serverat e UKT i cili është i instaluar në Data Center.

2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të projekti do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues të këtij projekti dhe periudha e implementimit të sistemit do të jetë nga 1 deri në 3 muaj kalendarik për regjistrimin manual të faturave dhe nga 1 deri në 3 muaj kalendarik për integrimin me sistemin e faturimit pas firmosjes së kontratës.

4. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Funksionalitetet e komunikimit të këtij sistemi me sistemet e tjera ekzistuese tashmë në UKT janë:

(1) Me sistemin e menaxhimit të e-mail-eve; Kjo lidhje kërkohej të realizohej minimalisht për ngjarje të reja në sistem; njoftim për fatura manual në pritje për aprovim; njoftim për fatura në blerje për aprovim; etj.. njoftime të ngjashme.

(2) Me sistemin e faturimit (për marrjen e faturave të reja të leshuara për periudhën; si dhe kthimit në arkive të sistemit të faturimit të faturave elektronike të leshuara); Integrimi duhet të përfshijë leximin nga sistemi i faturimit si dhe përgjigjen nga sistemi i fiskalizimit për 1) elementet e detyrueshëm të faturës të furnizimit të shërbimit që kërkohen për fiskalizim; si dhe 2) konfirmimin e statuseve të fiskalizimit të faturave si dhe dergimit të kodeve IIC; FIC dhe EIC – perkates të leshuar nga server i tatimeve (CIS).

(3) Bankat e nivelit të dytë në vend, për publikimin e faturave nepermje një shërbimi online të sigurtë. Nderfaqe që ka të bëjë me verifikimin nga ana subjekte që ofrojnë shërbimin e pagesës së faturave të leshuara si dhe status të pagesës së faturave);

5. GARANCIA & MIREMBAJTJA

Periudha e mirëmbajtjes garancisë së sistemit do të jetë për 1 vit.

Përgjigjja dhe shkallëzimi i shërbimit.

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre sipas rëndësisë së tyre.

| Kategoria A (Kritik/ i Lartë) | Kategoria B (i Mesëm) | Kategoria C (i Ulët) |
|--|---|--|
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal | Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal | Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin |
| Numri i përdoruesve të ndikuar | | |
| Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve | Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve | Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues |
| Pezullimi i punës | | |
| Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre. | Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre | Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre |
| Zgjidhje alternative e përkohshme | | |
| Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit | Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. | Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. |
| Koha e përgjigjes | | |

| | | |
|---|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • 15 min. për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 60 min. | <ul style="list-style-type: none"> • 60 min për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 4 orëve | <ul style="list-style-type: none"> • 120 min për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 48 orëve |
| Koha e zgjidhjes | | |
| Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike. |

6. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Bazuar në komponentët e kërkuar të sistemit, vlerësohet që implementimi i këtij projekti për ndërtimin e sistemit informatikë me funksionalitetet dhe trajnimin e stafit të zgjasë 1 muaj. Në vijim paraqitet procesi në formën e një diagrame *Gant* duke e ndarë projektin në nivel të proceseve kryesore që pritet të zhvillohen:

| Nr | Përshkrimi i mallrave | Muaji | |
|----|---|-------|----------|
| | | I-III | IV - XII |
| 1 | Sistemi i fiskalizimit dhe e-fatures per periudhen 1 vjecare. | X | |
| 2 | Moduli i lidhjes automatike me modelin API per raportimin e faturave te shitjes; nga sistemi i brendshem i faturimit. | X | |
| 3 | Sistemi i leshimi i faturave manual ne zyrat rajonet e UKT; | X | |
| 4 | Sistemi i miratimit te faturave ne blerjen, ne nje workflow me minimalisht 3 hapa / aprovime | X | |
| 5 | Sistemi i raportimit BI, mbi raportimin dhe analizen mbi faturat | X | |
| 6 | Sherbimi ëeb per lidhjen online te operatoret e pagesave. | X | |
| 7 | Mirembajtje ne vend per periudhe 1 vjecare | X | X |

Shenim: Sistemi qe kerkohet te prokurohet duhet te jete i gatshem dhe te kete marre paraprakisht lejet apo licensimin e nevojshem te AKSHI apo te Drejtorise se Pergjitheshme te tatimeve. Nderhyrje apo zhvillime ne program per nevoja te UKT nuk duhet te realizohen. Pershtatja me nevoje te UKT kerkohet vetem ne Integrimet me sisteme te UKT per fiskalizim si dhe per arkivim te faturave duhet te kryhen nepemjet nderfaqeve te hapura API te cila nuk kerkohet te jene specifike per UKT.

Per kete, koha e zbatimit 2 javore planifikohet te konsistoje ne testimet te API per UKT; ndersa dokumentacioni i pregatitur per perdoruesit eshte ai standard!

6. KERKESA FUNKSIONALE

1. Kërkesa te pergjitheshme.

Sistemi i fiskalizimit do te duhet minimalisht te ofroje sherbimet si meposhte:

- fiskalizimin e faturës pa-para ne dore dhe faturës elektronike me nënshkrim elektronik si edhe marrjen e mesazhit per statusin e faturës elektronike.
- Integrimi duhet te perfshije leximin nga sistemi i faturimit si dhe pergjigjen nga sistemi i fiskalizimit per 1) elementet e detyrueshëm te faturës te furnizimit te shërbimit qe kërkohen per fiskalizim; si dhe 2) konfirmin e statuseve te fiskalizimit te faturave si dhe dergimit te kodeve IIC; FIC dhe EIC – perkates te leshuar nga server i tatimeve (CIS).
- Gjithe te dhënat per faturat e shërbimeve do plotësohen ne sistemin e faturimit ekzistues te UKT dhe bazën e te dhënave te këtij sistemi, dhe kerkohet marrja e tyre nga ky sistem.
- Zgjidhja software do te duhet gjithashtu te lejoje hedhjen manuale online te faturave te tjera te aktivitetit qe nuk mbahen ne sistemin e faturimit. Te tilla si fatura te blerjeve nga jashte, vetefaturimet apo te ngjashme.
- Zgjidhja software, vec funksioneve te hedhjes manual te faturave per fiskalizim do te duhet te ofroje sherbimet per hedhje te shpejte te veprimeve te shitjes; nepermjet perdorimi te menuve te dedikuar per shitje me klientelen; ekraneve me prekje, skanimin e arikujve apo mundesi te ngjashme;
- Zgjidhja softëare do te duhet gjithashtu te mundesoje konfirmin online te faturave te blerjes prane sistemit te tatimeve CIS. Kjo hedhje faturave duhet te kryhet duke kaluar dy hapa ate te hedhesit te fatures si dhe te konfirmuesit.
- Zgjidhja duhet te ofroje mundesine e ndertimit te raporteve te perpunimit te faturave nga nje mjet qe sherben per analizen dhe raportimin ne formen e nje sistemi te didikuar BI. Ku perdoruesi fundore mundet te ndertoje raporte apo analiza te faturave, ne menyre te pamvarur pa nevojte te programit apo modifikimeve ne baze te dhenave te sistemit te fiskalizimit.

Zgjidhja software do te jete ne modelin cloud dhe te mos kerkoje instalime (vec atyre te nevojeshme per marrjen e faturave te faturimit) prane paisjeve te UKT.

Zgjidhja duhet te garantoje nje shpejtesi te pergjitheshme te realizimit te sherbimit ne fiskalizimit te faturave dhe faturave elektronike ne jo me ngadale se ne 4 (kater) dite pune. Keto kapacitete perpunimi kerkohet te garantojen ne servera te jashtem cloud (brenda EU) qe kane shkalle sigurie te njete apo me te larte se serverat lokale. Zgjidhja cloud duhet te lejoje ndryshimin (shtimin apo zvoglimin e kapaciteve) ne kohe reale. Kjo do te mundesoje vijueshmeri te aktivitet normal te punes edhe pergjate diteve te fiskalizimit te faturave te periudhes.

Per kete zgjidhja duhet te garantoje ne kushte optimale, nje shpejtesi fiskalizimi prej jo me pak se 100,000 Fatura ne dite.

2. Funksionalitetet e sistemit

-
- Programi kërkohej të jetë plotësisht web, i sigurtë dhe i përdorshëm në cloud pa nevojë instalimi në kompjutera desktop apo në server të UKT. Aplikacioni aksesohet nëpërmjet ndërfaqes web nëpërmjet një browseri. Shkalla e operimit të sistemit duhet të jetë jo më pak se 99.8%.
 - Server (cloud) duhet të jetë i dedikuar për nevojat e fiskalizimit të UKT; ai nuk duhet të jetë i aksesueshëm nga përdorues të tjerë (vec personelit teknik të operatorit ekonomik); Sistemi duhet të ofrojë shërbimin e backup automatik të pakten një herë në ditë në një datacenter tjetër minimalisht 100K larg të parit.
 - Lidhja e server cloud me infrastrukturën (data center) të UKT duhet të realizohet në një shkallë të lartë sigurie me encryptim të lartë dhe duke përdorur teknologjinë VPN që lejon kalimin e të dhënave në rrjetë plotësisht private dhe të mbrojtur nga nderhyrjet. Server cloud duhet gjithashtu të ofrojë shërbime firewall ku të kufizohen të gjithë akseset jashtëm.
 - Kanali i lidhjes midis browser-it dhe serverit është i kriptuar me TLS/SSL nëpërmjet protokollit HTTPS.
 - Sistemi ofron të gjitha funksionalitetet, të ofruara si nga pajisje desktop ashtu edhe ato mobile. Instalimi i aplikimit mobile, duhet të përdoret vetëm për raportime dhe për aksesuar sistemin e raportimit BI. Funksionet e tjera nuk duhet të kenë nevojë për instalim mobile.
 - Aplikacioni është i mbrojtur nga sulmet e injektimit të skriptëve;
 - Bazat e të dhënave e tipit RDBMS, janë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi. Sistemi duhet të garantojë replikimin në kohë reale në një pajisje kompjuterike të jashtme për të garantuar replikimin e të dhënave në kohë reale. Ky replikim i RDBMS kërkohej të kryhet në Cloud për të garantuar që shpejtësia e ruajtjes është e përshtatshme. Ky replikim është i ndryshëm nga nevojat për arkivimin e faturave, të cilat kërkohej të kryhen në server e faturimit al-billing. Për këtë, RDBMS e ofruar duhet të suportojë replikim në kohë reale!
 - Sistemi duhet të ofrojë një sistem raportimi të avancuar për analizën e faturave dhe të operacioneve mbi faturat. Ky sistem duhet të jetë i formës BI (*Business Intelligence*) dhe të garantojë ndërtimin dhe ekzekutimin e pamvarur të përdoruesve të UKT të raporteve të reja.
 - Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e identifikimit të sigurtë të përdoruesit në disa nivele (*multiform authentication, MFA*). Kjo duhet të garantojë nëpërmjet dërgimit të kodeve të sigurisë për çdo lidhje në sistem. Kodet e sigurisë duhet të mundësohen nëpërmjet dërgimit të emails ose të mesazheve sms nëpërmjet operatorëve celularë lokalë.
 - Sistemi duhet të verifikojë fortësinë e pasvordëve të përdoruesve; dhe të mos lejojë përdorimin e passvordëve të dobët por duhet të kërkojë përdorimin e detyrueshëm të algoritmeve të sotme të kombinimit të karaktereve si dhe numrave apo katakterëve të vecantë. Përdoruesi duhet të ketë mundësinë e ndryshimit të sigurtë të pasvordit. Çdo veprim i tillë duhet të shoqërohet me njoftimin e përdoruesit.
 - Serveri i programit të jetë i ndarë nga baza e të dhënave të klientit. Kjo duhet të garantojë që çdo përditësim në sistemin e fiskalizimit, NUK do të ndikojë në operimin e sistemit të faturimit.

-
- Kontrolli kryhet statusin e cdo NIPT-i para se te leshohet fatura.
 - Hedhja e veprimeve (faturave) ne sistemit behet sipas parimit te kontrolli te kater syve. Per kete, sistemi duhet te mundesoje ndarjen e profileve midis hedhesit te veprimeve si dhe aprovuesit.
 - Ne menyre te njejte sistemi duhet te garantoje kontroll, nje, dy apo me shume aprovimeve ne rastet e faturave ne blerje. Per me shume, sistemi duhet te mundesoje organizimin e perdoruesve ne qendra te ndryshme shpenzimesh. Cdo qender shpenzimesh duhet te operoje ne menyre te pavrarur ne aprimin e faturave ne blerje. Per kete, faturat ne nje qender blerje duhet te mos te aksesohen nga qendrat e tjera te shpenzimeve.
 - Sistemi realizon edhe ndarjen e te drejtave te perdoruesve sipas qendrave te kostove (NIPT-eve sekondare dhe sipas Arkave te operimit). Cdo perdoruesi i caktuar ne nje qender kosto apo ne nje TCR (pike leshimit te faturave) duhet te shoh vetem veprimet qe lidhen me qendren perkatese te kostos. Sistemi kerkoet gjithashtu te mundesoje edhe shtimin e hallkave shtese (si ai i kontabilitetit qe ben aprovimin final perpara deklarimit prane tatimeve) nese do te kerkoen ne vazhdim.
 - Sistemi duhet te ofroje funksionalitete te hedhjes se shpejte te veprimeve ne shitje. Kjo te mundesohet ne paisje PC dhe te jete i peshtatur per shitje direkte duke perdorur ekrane me prekje. Ne kete sistem, nje shitje te garantohet te realizohet ne jo me shume se 3 click apo 3 butona ne ekrane me prekje. Per kete sistemi duhet te lejoje edhe administrimin e listes se cmimeve te sherbimeve, qe shoqerojne sherbimin.
 - Sistemi duhet te garantoje rakordimet e gjendjes se arkave te perdorura ne shitje me shumen e raportuar prane serverit te tatimeve. Ne cdo moment, perdoruesit mundet te shohin gjendjen e arkës si dhe raportimin e kryer prane tatimeve. Gjendja midis te dy sistemeve (fiskalizimit si dhe taksave CIS) duhet te jete e NJEJTE!
 - Sistemi duhet te mundesoje problemet teknike te mundeshme qe lidhen me mos operimin e sistemit te tatimeve. Ai duhet te raportoje mbi faturat e raportuara apo ato ne pritje per raportim dhe duhet te verifikoje ne kohe reale kthimin ne operim te serverit te tatimeve. Sapo ky server te jete operativ apo aksesueshem, sistemi duhet te ridergoje faturat e raportuara, pa nderhyrjen manuale te perdoruesit.
 - Sistemi te mundesoje njoftimin ne kohe te caktuar per cdo fature te re blerjeje te raportuar nga shitesit prane sistemit te tatimeve. Vec njoftimit, per perdoruesit e loguar ne sistem, ai duhet te mundesoje kontrollin ne kohe reale te faturave te blerjes se raportuara prane serverit te tatimeve.
 - Sistemi te mundesoje raportimin ne kohe reale te gjendjes se faturave te shitjes, ne lidhje direkte nga DPT.
 - Funksionalitetet e sistemit arrihen me parametrizime dhe konfigurime. Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë. Kjo garanton qe UKT mundet te kryeje pershtatje te sistemit si dhe te listes se perdoruesve pa nevojën e prodhuesit te zgjidhjes.
 - Sistemi duhet te mundesoje njoftimin automatik te perdoruesve lidhur me ndryshime apo nderhyrje te mundeshme ne sistem;

-
- Në çdo modul dhe çdo formë të tij, aplikacioni mundeson export masiv të dhënash në bazë dokumentash excel ose csv.
 - Sistemi te ofroj nderfaqe automatike per shkembimin e te dhenave te faturave si dhe dokumenta te tjere te nevojshem per fiskalizimin sic mundet te jene fatura per kliente te pergjithshem ose dokumenta shoqerues.
 - Sistemi te paraqes informacion per faturat e derguara sipas statusit te derguar me sukses apo jo.
 - Sistemi te mundesoje shkembimin automatike te te dhenave qe lidhen me faturat per biznese, qeveri si dhe kliente fundore te paidentifikuar. Gjithashtu, sistemi duhet te lejoj fiskalizimin e dokumentave shoqerues.
 - Sistemi duhet te lejoj te krijosh faturat manualisht.
 - Sistemi vec lidhjes me sistemin e faturimit, duhet te mundesoje lidhje te tjera ne menyre te pakufizuar prsh me sisteme te aktivizimit apo financiar, etj .. te ngjashem. Kjo lidhje (Integrim) duhet te realizohet nepemjet nderfaqeve te hapura API dhe *pa programim!*
 - Sistemi nuk duhet të lejojë fshirje rekordesh.
 - Sistemi duhet te lejoje shaqjen e gjendjes se fatures apo fazen e proceset ne menyre grafikë dhe të thjeshta për tu kuptuar jo vetëm prej stafit teknik por edhe stafit menaxhues (etj).
 - Sistemi duhet të ofrojë mundësi njoftimi me email-e të të gjithë përdoruesave të përfshirë në një çështje apo menaxherë të organizatës në nivele të ndryshme. Per kete, sistemi duhet minimalisht te ofroje njoftime per status te faturave, nevojte per aprvimin e faturave manuale, ngjarje kryesore ne sistem apo fature e re ne blerje qe kerkon aprovim.
 - Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e regjistrimit të të gjitha aktiviteteve që ndodhin në çështje në formë “Logs” të ndara në kategori të ndryshme për të gjitha veprimet që do të kryhen në sistem.
 - Trajnimi eshte i perfshire ne kete projekt dhe do te ofrohet nga Operatori Ekonomik fitues.

Shenim: Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 3, datë 20.01.2020, subjekt i fiskalizimit të faturës do të jenë edhe organet publike . Cdo fature qe ato leshojne duhet te jete e fiskalizuar ne perputhje me ligjin e cituar me siper. UKT si nje organ publik ka detyrim ligjor qe te zbatoje ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

| Shërbimet | Përshkrimi | Shuma | Vendi i ekzekutimit | Afati i ekzekutimit |
|------------------|-------------------|--------------|----------------------------|----------------------------|
| | | | | |
| | | | | |

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim:*Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/entë kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën **137, 666 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit, (2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e 2020,2021, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 1,376,666 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 e vlefshme, (**ose ekuivalente**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 20000 mbi “Sistemet e menaxhimit të informacionit”, e vlefshme (**ose ekuivalente**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) 1 punonjës të çertifikuar për mirëmbajtje rrjetesh.
